



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 553/2023

Datë: 27 korrik 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 5 paragrafët 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe nenit 1 paragrafët 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullores Nr. 04/2023 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 27 korrik 2023:

**VENDIM**

- I. Plotësohet dhe Ndryshohet vendimi KPK/Nr. 421/2023 i datës 31 maj 2023.
- II. Konkursi i shpallur për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë sipas vendimit KPK/Nr. 399/2023 i datës 23 maj 2023 do të jetë i hapur 15 ditë nga data 1 gusht 2023.
- III. Konkursi duhet të përmbajë informatat e përcaktuara në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Rregulloren Nr. 04/2023 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe shpalljen e konkursit t'i publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe fizikisht në të gjitha ndërtesat e prokurorive.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku  


Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit Vlerësues;
- Anëtarëve të Komisionit për Rishqyrtim;
- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP-së;
- Arkivit të KPK-së.